



Ali Hamiti
Kryetar i Bordit
Zyra e Rregullatorit të Energjisë
Rr. Hamdi Mramori Nr.1
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

OPERATORI I SISTEMIT TË BARTJES DHE TREGUT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA d.d.

Nr. 177 Dt. 20.03.2008
PRISHTINË-A

20 Mars 2008

Rishikimi i tarifave të energjisë elektrike 2008

Përgjigja e KOSTT sh.a në Raportin Konsultativ të ZRrE-së

Kjo letër paraqet qëndrimet e KOSTT sh.a në Dokumentin Konsultativ për Rishikimin e Tarifave të Energjisë Elektrike të publikuar nga ZRrE me 10 mars 2008

KOSTT sh.a mirëpret mundësinë për tu përgjigjur në Dokumentin Konsultativ të ZRrE-së për rishikimin e tarifave për energjinë elektrike për vitin 2008 të publikuar me 10 mars 2008. Përgjigjet fokusohen në çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e kostove që do të vjelen nga klientët përmes tarifave të transmisionit si dhe procesin për përcaktimin e të hyrave të lejuara.

Periudha tarifore dhe Procesi i vendosjes së tarifave

Procesi i vendosjes së tarifave

Metodologjia tarifore për sektorin e energjisë e publikuar nga ZRrE në dhjetor të vitit 2006 ka përcaktuar se periudha fillestare e kontrollit të çmimeve duhet të jetë për një periudhë 3 vjeçare. Në përgjithësi është e njohur se periudhat më të gjata të kontrollit të çmimeve mundësojnë efikasitet më të lartë në investime si dhe sigurojnë stimulime më të forta për kompaninë për të ulur kostot. Megjithatë, ka qenë e konstatuar se në Kosovë ka pasur paqartësi të dukshme në lidhje me të dhënat ekzistuese apo ato të parashikuara për të ardhmen, prandaj periudha më e shkurtë do të zvogëlonte dallimet e mundshme në mes të kostove aktuale dhe të hyrave të lejuara;

Për periudhën 1 janar 2007 deri me 31 mars 2007 janë vendosur tarifatat e përkohshme dhe më pas janë zgjatur edhe për një muaj; po ashtu janë bërë përshtatje edhe për të ardhurat mujore të KOSTT-it si rezultat i pasqyrimeve të industrisë. Me 31 maj 2007, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka publikuar vendimin në lidhje me tarifatat pas asaj date, dhe ka kërkuar që tarifatat e reja duhet të hyjnë në fuqi nga data 1 maj 2007. Nga kjo, KOSTT ka besuar që tarifatat e reja do të aplikohen për periudhë 12 mujore nga data 1 maj 2007.

KOSTT ka pranuar se gjatë periudhës transitorë, do të duhet të bëhen përshtatje të afateve për të marrë parasysh ngjarjet e paparashikuara apo informatat e reja; po ashtu KOSTT ka marrë parasysh se ky është një proces i ri për bizneset dhe organizatat në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, procesi i cili është përcjellur deri më tani, ka shpër në pasiguri të dukshme KOSTT-in dhe klientët e tij dhe po që se të vazhdohet në këtë mënyrë, kjo do të shpie në vendime jo optimale për investime dhe kursime të redukuara të kostos për sektorin. Është e rëndësishme që për të shkuar përpara të zhvillohet një orar i përshtatshëm dhe fuqishëm për përcaktimin dhe finalizimin e Tarifave Për shembull, ne besojmë se ZRRrE nuk do të mund ti marrë në konsiderim si duhet komentet konsultative, të përmirësoj modelet e tarifave në mënyrë të përshtatshme (për shembull të marrë parasysh rekonsilimin në mes të vëllimeve aktuale dhe të parashikuara), të publikoj tarifat finale, si dhe t'i mundësojë kohë të disponueshme KOSTT-it për të implementuar tarifatat e reja në periudhën 20 mars deri me 1 prill 2008.

Periudhat tarifore

Legjislacioni financiar në Republikën e Kosovës¹ obligon organizatat biznesore që të raportojnë/përgatisin raportet financiare në bazë të vitit kalendarik d.m.th Janar-31 Dhjetor.

Aranzhimet aktuale për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara realizohen në formë tjetër nga kjo praktikë duke i aplikuar tarifatat prej prillit deri me 31 mars. Kjo mospërputhje e afateve shton në masë të konsiderueshme barrë në kontabilitet për KOSTT-in dhe supozojmë se edhe për ndërmarrjet e tjera të energjisë në rajon. Në juridiksionet e tjera, nevoja për përcaktimin e të hyrave bëhen nga raundet kontraktuale të konsumatorëve (të cilat tradicionalisht janë realizuar në periudhën prill deri mars). Pasi që aktualisht në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë, janë vetëm një numër i vogël i pjesëmarrësve, tani kjo duket të jetë kohë e përshtatshme që të konsiderohet ndryshimi i aranzhimeve në mënyrë që të hyrat e lejuara të aplikohen në baza të njëjta sikurse periudhat formale të kontabilitetit për biznese.

Prandaj, KOSTT insiston që për rishikimin e periudhës së re tarifore që fillon në vitin 2010, ZRRrE të ndërmer hapa të duhur për vendosjen e tarifave dhe procesin e rishikimit në bazë të vitit kalendarik.

Kompensimi për pagesat e humbjeve të transmisionit për vitin 2007

Natyrisht se KOSTT është i zhgënjyer që nuk është rikompensuar për koston totale të humbjeve në transmision gjatë vitit 2007, por kupton se qëllimi është që KOSTT duhet të ketë nxitje për kontrollimin e humbjeve.

Tabela 2 dhe Tabela 4 e dokumentit konsultativ, ofrojnë shifra për Humbjet e Lejuara në Transit për vitin 2007 si dhe shifrat Reale të Humbjeve në Transit për vitin 2007; ne besojmë se në tabelë është përvjedhur një gabim në relacion me Humbjet Reale në Transit.

Shpenzimet Kapitale të Pa-financuara

KOSTT pajtohet se përshtatjet në këtë fushë janë të duhura.

¹ Rregullorja 2002/3 për Tatimet në Profit në Kosovë

Rekonsilimi

Metodologjia Tarifore e publikuar nga ZRrE në dhjetor të vitit 2006, ka lejuar rekonsilimi të volumeve reale kundrejt volumeve të parashikuara dhe ekuacioni 4-6 lejon që të aplikohet OST Faktori i Korrigjimit. Modeli për kalkulimin e Tarifave për vitin 2008 nuk merr parasysh përshtatjet e nevojshme të volumeve dhe kjo duhet të përmirësohet në pajtim me Metodologjinë Tarifore. KOSTT propozon vlerat e rekonsiliuara duhet të shtohen në të hyrat e vitit 2009. Nga kjo, dhe në mënyrë që të ndiqen parimet e mbledhjes së të ardhurave, ne presim që rikonsilimi t'i mundësoj KOSTT-it që të përmirësoj deficitin i cili ka rrjedhur si pasojë e implementimit të tarifave të reja më të ulta për "HC Lumbardhi" për vitin 2007.

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC)

KOSTT vëren se vendimi i propozuar për të mbajtur koston ekzistuese të kapitalit si për KOSTT ashtu edhe për KEK për vitin 2008, mund edhe të jetë i parëndësishëm pasi që aktualisht pothuaj se të gjitha shpenzimet kapitale financohen përmes granteve. Megjithatë, KOSTT nuk pranon argumentet e ZRrE-së që mbështesin mendimin se WACC-u duhet të mbetet në nivelin aktual; p.sh. për shkak se KEK nuk e ka konsideruar ngritjen e këtij niveli.

Është me rëndësi që të krijohet parimi që në vitet e ardhshme koston e kapitalit në mes të KOSTT dhe KEK mund të ndryshojnë. Këto janë biznese fundamentalisht të ndryshme me shkallë potencialisht të ndryshme të kredive (raporti ndërmjet borxhit dhe ekuitetit). Do të jetë e rëndësishme që të rishikohet ky vendim në vitet në vijim kur të jenë në dispozicion faktet e provuara të koston dhe shkallës së huamarrjes.

Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara

KOSTT kërkon që ZRrE të lejoj variacione në kalkulimin e pjesëve përbërëse të të Hyrave të Lejuara; ndryshimet e propozuara nuk do të rezultojnë me ndryshime në vlerën totale prej €14,774.7.

Përshtatjet e propozuara janë si më poshtë:

	€000		
Shpenzimet Operative – Mirëmbajtja			(286.2)
Shpenzimet Kapitale – Financimi i Burimeve të tjera rritet për		3,476.6	
Efekti neto i këtyre ndryshimeve do të jetë:			
	Aktuale	E propozuar	Ndryshimi
Amortizimi Total	724.2	773.9	49.7
Kthimi i lejueshëm	105.4	341.9	236.5
			286.2
Ndryshimi Neto në të hyrat e lejuara			0.0

Ngjitja në shpenzimet kapitale kërkohet për të avancuar punën në instalimin e transformatorit të ri prej 150 MVA në TS Prizreni 2 apo TS Prishtina 4.

KOSTT vëren se vendimi i ZRrE-së për nivelin e kostos së lejuar dhe të hyrave të lejuara rezulton në KOSTT duke treguar humbje prej €2,567m në pasqyrat financiare të vitit 2008 të prezantuara në Modelin Tarifor dhe të të Hyrave.

Sinqerisht,

pozi
Fadil ISMAILI
Drejtor Menaxhues



Cc. Theranda Beqiri, anëtare e Bordit të ZRrE, ZrRE
Nysret Avdiu, anëtar i Bordit të ZRrE, ZRrE
Rifat Blakaj, Udhëheqës i Depart. për furnizim me energji dhe strukturë të tregut, ZRrE
Afrim Ajvazi, u.d. udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencave, ZRrE